



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија" бр.5, 1000 Скопје | тел.02/3218 130 факс.02/3218 131 | contact@ssrm.mk
Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel.02/3218 130 faksi.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Në bazë të nenit 105 paragrafi (1) alinea (1) nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 41 dhe neni 46 paragrafi (1) pika (1) të Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë" nr.58/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.96/19) dhe neni 47 paragrafi (1), neni 49 dhe neni 50 paragrafi (1) të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.102/19), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur me datë 10.03.2025 miratoi:

VENDIM PËR ZGJEDHJEN E GJYQTARIT NË GJYKATËN THEMELORE TETOVË

Për gjyqtare në Gjykatën Themelore Tetovë është zgjedhur:

1.Arlinda Osmani - Kandidat i Akademisë për Gjykatës dhe Prokuror Publik;

Ky vendim do të hy në fuqi pas mbarimit të potëfuqishëm të procedurës dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

ARSYETIM

Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut publikoi shpallje për zgjedhjen e gjyqtarve në Gjykatën Themelore Tetovë ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.27/2025 nga 07.02.2025).

Në shpalljen e publikur për në Gjykatën Themelore Tetovë janë paraqitur 4 kandidatë të cilët i kanë plotësuar kushtet e paraparë me ligj.

Procedurën për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Tetovë, Këshilli e zbatoi në pajtim me Ligjin për gjykata, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor të Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Rregullat për renditjen e kandidatëve për gjyqtarë nga Akademia e Gjykatës dhe Prokuror Publikë.

Këshilli zhvilloi test psikologjik për të kontrolluar aftësitë sociale dhe test integriteti për të kontrolluar vlerat etike dhe morale të kandidatëve, test për të kontrolluar njohuritë e punës praktike me kompjuter dhe zhvilloi intervistë me kandidatët.

Këshilli formoi Komision të përbërë nga anëtarë të Këshillit, i cili përpiloi listën e renditjes dhe i dorëzoi Këshillit listën e mëposhtme të renditjes së kandidatëve:

Në bazë të nenit 23 të Rregullores për punë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 74/19, 186/20 dhe 5/23), Këshilli Gjyqësor ka votuar sipas rënditjes.

Nr. Rend	Emri	Mbiemri	Viti i përfundimit të AGJPP	Pikat nga Komisioni nga intervista e realizuar	Pikat e arritjeve nga AGJPP	Numri total i pikave	Gjykata për të cilën ka aplikuar
1	Arlinda	Osmani	16.01.2025	5,59	55,92	61,51	Gjykata Themelore Tetovë
2	Emira	Asani	16.01.2025	5.38	53,87	59,25	Gjykata Themelore Tetovë
3	Borçe	Kostovski	16.01.2025	5.34	53,43	58,77	Gjykata Themelore Tetovë
4	Admire	Ademi	16.01.2025	5,23	52,33	57,56	Gjykata Themelore Tetovë

Kandidati nga ranglista Arlinda Osmani, me 13 vota "Për" dhe asnjë "Kundër" mori shumicën e kërkuar të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote. Me 5 vota "për", kandidati mori shumicën e votëve edhe nga pjesëtarët e pranishëm që u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Secili anëtar i Këshillit me të drejtë vote ka dhënë shpjegime për vendimin e tij për zgjedhjen e gjyqtarit siç parashihet në nenin 49 paragrafi (3) të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kandidati Arlinda Osmani është kandidati nga gjenerata e 8-të e kandidatëve nga Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publik, ka diplomuar në Fakultetin Juridik pran Universiteti i Evropës Juglindor-Tetovë, ndërsa provimin e jurisprudence e ka dhënë më 12.12.2014 ka përvojë pune gjithësej 12 vjet e 6 muaj e 12 dit dhe 10 vjet e 2 muaj e 8 ditë pas dhënies së provimit të jurisprudence.

Duke marrë parasysh si më sipër, Këshilli e zgjedhi Arlinda Osmani, për gjyqtare në Gjykatën Themelore Tetovë.

**KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Kryetar

M-r Aleksandar Kamboyski

Nr.09-666/1

18.03.2025

Shkup